



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

VENDIM

Nr. 469, datë 25.07.2023

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/a i Kodit Penal.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Besnik Hoxha (relator), Enkeleda Dalipi dhe Sokol Pasho, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Neni 283/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Migena Laska, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Neni 139-25 i Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Migena Laska, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës

së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...};
Akuza: Nenet 78/1-22, 278/1, 83-22 të Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Sokol Pasho, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 290/1/3 i Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR